



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_. \_\_. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 115, Datë 04 / 05 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.Regj.28, datë 23.02.2018 të shtetasit L. M, me pretendimin e diskriminimit nga ana e: Drejtorit të IEVP Fier, Shefit të Regjimit të Brendshëm, Shefit të Llogjistikës, Shefit të Kujdesit Social, Inspektorit të Grupit të Sigurisë dhe stafit të Shërbimit Policor, pranë IEVP Fier<sup>1</sup>, për shkak të gjendjes së tij shoqërore.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Shtetasi L. M shprehet se gjatë vuajtjes së dënimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fier i kanë vdekur bashkëshortja dhe djali në një aksident automobilistik. Prindërit dhe motra nuk jetojnë më dhe ai nuk ka njerëz të afërt që ta ndihmojnë. Në këto kushte, ai shprehet se i është drejtuar me një kërkesë Drejtorisë së IEVP Fier, ku ka kërkuar t’i sigurohen materialet e nevojshme higjieno-sanitare, etj. Z.M shprehet se nuk ka marrë asnjë përgjigje apo reagim të IEVP-së Fier ndaj kërkesës së tij. Ai pretendon se përveç indiferentizmit dhe shpërfilljes të këtyre kërkesave nga ana e strukturave të këtij Institucioni, ndaj tij janë ndërmarrë një sërë sjelljesh diskriminuese dhe poshtëruese. Kështu, ai pretendon se është torturuar fizikisht dhe psikologjikisht nga ana e policëve të shërbimit pranë kësaj IEVP-je: I. S, R. S dhe U. P, të

<sup>1</sup> Bashkëngjit ankesa me nr.28 regj., datë 23.02.2018.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën: KMD.

cilët me veprimet e tyre të kryera me dashje, i kanë shkaktuar atij vuajtje të rënda fizike, mendore, dhe po ashtu kanë nxitur të dënuarit e tjerë (P. Ç dhe E. J) për t'i bërë presion dhe për ta frikësuar, në mënyrë që ai të heqë dorë nga kërkesat e tij. Për të gjitha këto veprime, ankuesi shprehet se ka vënë në dijeni Drejtorinë e IEVP Fier dhe instancat e tjera por nga ana e tyre nuk është marrë asnjë masë për rregullimin e situatës së krijuar.

Në përfundim të ankesës së tij, ankuesi kërkon të konstatohet se ndaj tij ka patur sjellje dhe veprime diskriminuese nga ana e : Drejtorit të IEVP Fier, Shefit të Regjimit të Brendshëm, Shefit të Llogjistikës, Shefit të Kujdesit Social, Inspektorit të Grupit të Sigurisë dhe stafit të Shërbimit Policor, pranë IEVP Fier.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>4</sup> ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

<sup>3</sup> Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

1. Me shkresën nr.292/2 prot, datë 09.03.2018, Komisioneri i kërkoi informacion: Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fier, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (SHKB), pranë Ministrisë së Drejtësisë, mbi pretendimin e ngritur nga shtetasi L. M.
  - Me shkresën nr.3054/1 prot., datë 28.03.2018, Ministria e Drejtësisë ka informuar Komisionerin se të gjitha pretendimet e shtetasit L. M do të verifikohen shumë shpejt dhe lidhur me rezultatet do të informohet shkresërisht.
  - Me shkresën nr.1514/3 prot., datë 10.04.2018 Ministria e Drejtësisë ka informuar Komisionerin se: *“Lidhur me pretendimet e paraqitura nga ana e ankuesit, janë bërë të gjitha verifikimet nga strukturat përkatëse dhe ka rezultuar se ato nuk qëndrojnë pasi nuk janë të provuara”*.
  - Me shkresën nr.737/1-M prot., datë 16.04.2018 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve informon Komisionerin se: *“...Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka ngritur një ekip për të inspektuar lidhur me pretendimet e shtetasit L. M dhe në përfundim nuk ka gjetur fakte që të vërtetohen pretendimet e tij. Me qëllim mbështetjen emocionale dhe sigurinë e tij, janë dhënë porosi stafit të shërbimit social për rritjen e vëmendjes dhe kujdesit ndaj ankuesit. DPB, në pamundësi për sistemimin e këtij shtetasi në IEVP Fier, për arsye të konflikteve me të dënuar të tjerë, e ka transferuar në IEVP Peqin”*.
2. Me shkresën nr.292/4 prot., datë 16.04.2018 Komisioneri iu drejtua sërish Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve Tiranë, lidhur me paraqitjen e dokumentacionit provues sa i takon konkluzioneve të nxjerra nga strukturat përkatëse për pretendimet e ngritura nga shtetasi M.
  - Me shkresën nr.663/1 prot., datë 24.03.2018 Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve (SHKB) informon Komisionerin se lidhur me ankesën e këtij shtetasi janë bërë verifikimet e nevojshme. Në shkresë citohet se: *“...Sipas intervistës së bërë me të nga ana e Inspektorit të kësaj strukture, ai është shprehur se ka një trajtim të rregullt nga drejtuesit e IEVP-së Fier dhe ndodhet i akomoduar në spitalin e këtij Institucioni më kërkesë të tij. Ai shprehimisht ka thënë se nuk ka asnjë ankesë ndaj drejtorit të IEVP-së, Shefit të Policisë etj”*. Ndërsa, lidhur me pretendimin se nuk i janë siguruar materialet e nevojshme higjeno-sanitare, Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve ka depozituar në cilësi prove procesverbalet e datave: 20.12.2017, 29.01.2018, 27.02.2018, 16.03.2018, nga përmbajtja e të cilëve rezultojnë se është bërë shpërndarja e detergjentëve për të gjithë të dënuarit, sipas godinave, ndërmjet të cilëve edhe shtetasi L. M.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

### **III. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

*Lidhur me pretendimin e ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes shoqërore, nga ana e Drejtorit të IEVP-së Fier, Shefit të Regjimit të Brendshëm, Shefit të Llogjistikës, Shefit të Kujdesit Social, Inspektorit të Grupit të Sigurisë dhe stafit të Shërbimit Policor, pranë IEVP Fier.*

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë të padenjë dhe është diskriminuar nga ana e Drejtorit të IEVP-së Fier, Shefit të Regjimit të Brendshëm, Shefit të Llogjistikës, Shefit të Kujdesit Social, Inspektorit të Grupit të Sigurisë dhe stafit të Shërbimit Policor, pranë IEVP Fier.

Personat e privuar nga liria kanë të garantuar ligjërisht mundësinë dhe gjithë mekanizmin për të ngritur një çështje, shqetësim, kërkesë dhe ankesë<sup>5</sup> nëse kjo është e nevojshme, kurdo që ata e gjykojnë se të drejtat e sanksionuara në ligje janë shkelur. Për këtë arsye, autoritetet e institucioneve penale duhet të ndërtojnë dhe të garantojnë funksionimin eficient të procedurave të kërkesë-ankesës, ku këto të fundit të shqyrtohen me seriozitet, efektivitet dhe në kohë.

E drejta e kërkesës dhe e ankimit si një e drejtë me karakter kushtetues. Neni 48 i Kushtetutës parashikon se: “Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.”.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) thekson se “ankesa efektive dhe procedurat e inspektimit janë garanci themelore kundër keqtrajtimit në institucionet e privimit të lirisë. Personat e privuar nga liria duhet t’i kenë rrugët të hapura për t’iu drejtuar organeve si brenda dhe jashtë kontekstit të sistemit të burgjeve, duke përfshirë edhe mundësinë që të kenë qasje konfidenciale pranë një autoriteti të përshtatshëm”.

Rregullorja Evropiane e Burgjeve lidhur me kërkesë ankesat e personave të privuar nga liria në sistemin e burgjeve sanksionon se: “Të burgosurit, individualisht ose si grup, duhet të kenë mundësi të mjaftueshme për të bërë kërkesa apo ankesa drejtuar drejtorit të burgut ose ndonjë

---

<sup>5</sup> Ankesat i referohen kundërshtimit me shkrim ose me gojë, përkundrejt marrjes së një vendimi, veprimi ose mos-veprimi të autoritetit të institucionit, me të cilin ata mund të mos jenë dakort.

*autoriteti tjetër kompetent. Nëse një kërkesë mohohet ose një ankesë refuzohet, të dënuarit duhet t'i ofrohen arsye dhe i dënuari do të ketë të drejtë të ankohet pranë një autoriteti të pavarur”.*

Kjo e drejtë ka gjetur pasqyrim dhe në ligjin nr. 8328, dt. 16.04. 1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve”, i ndryshuar. Konkretisht në nenin 8 të këtij ligji parashikohet se të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme dhe në mënyrë individuale.

Neni 49 i këtij ligji parashikon se nga pikëpamja formale ankesat mund të bëhen me gojë ose me shkrim dhe me zarf të mbyllur. Me anë të këtyre ankesave të dënuarit mund t'i drejtohen organeve të ndryshme të tilla si drejtorit të institucionit, inspektorëve, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Prokurorit, Gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit, Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, apo institucioneve të tjera shtetërore.

IEVP Fier, DPB dhe Ministria e Drejtësisë janë vënë në dijeni të pretendimeve për diskriminim të ankuesit nëpërmjet korrespondencës zyrtare me Komisionerin.

Në këto rrethana Ministria e Drejtësisë, DPB-ja dhe SHKB-ja kanë bërë verifikimet përkatëse lidhur me problematikën e ngritura nga shtetasi L. M.

Ligji nr.9397, datë 12.05.2005 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve”, në nenin 2 të tij, rregullon fushën e veprimtarisë së SHKB-së, e cila konsiston në parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin paraprak të veprimtarisë kriminale, të kryer nga punonjës të Policisë së Burgjeve, nga struktura të tjera të sistemit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe për çështje që lidhen me sigurinë në burgje.

Po ashtu neni 4 i këtij ligji ka përcatuar si autoritetin përgjegjës për veprimtarinë e SHKB-së, Ministrin e Drejtësisë<sup>6</sup>. Në zbatim të parashikimeve të nenit 14, të këtij ligji, SHKB-ja ushtron veprimtarinë informativo-gjurmuese dhe të hetimit paraprak, duke respektuar garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e njeriut, normat e Kodit të Procedurës Penale, ato për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, si dhe dispozitat e këtij ligji.

Inspektimi dhe mbikëqyrja e brendshme e burgjeve kryhet nëpërmjet inspektorëve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe inspektorëve e Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet e Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu, pjesë kontrolluese e personelit të burgjeve është Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve pranë Ministrisë së Drejtësisë. Fokus i inspektimeve të brendshme është përmbushja e detyrave funksionale të sektorëve të policisë; ai ligjor dhe i kujdesit social në institucione, ku mes të tjerash është edhe shqyrtimi i kërkesë/

---

<sup>6</sup> Ministri i Drejtësisë ose personi i autorizuar prej tij është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë dhe për ushtrimin normal të veprimtarisë së SHKB-së.

ankesave që vijnë në drejtim të sistemit të burgjeve dhe verifikimi në vend i situatave të caktuara të moskryerjes së detyrave të përcaktuara në bazën ligjore të personelit të burgjeve.

Bazuar në sa më lart, si dhe referuar dokumentacionit të siguruar gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se, pas këqyrjes dhe verifikimit të procesverbaleve të depozituara nga SHKB-ja, subjekti ankues ka mohuar të jetë ankuar ndaj drejtorit të I EVP Fier dhe ndaj Shefit të Policisë. Ai ka nënshkruar gjithashtu në procesverbalin e datës 08.03.2018, mbajtur mes tij dhe inspektorit të SHKB-së, se pretendimet e tij janë vetëm lidhur me punonjësin e policisë, z.O. S, pasi ai e shqetëson duke hapur derën e dhomës së spitalit ku ndodhej i akomoduar, në orare të papërshtatshme dhe mendon se ai është përdorues i lëndëve narkotike.

Lidhur me këtë pretendim nga ana e inspektorit të SHKB-së janë bërë verifikimet e nevojshme, reflektuar në procesverbalin e datës 13.03.2018, dhe në përfundim ka rezultuar se pretendimet e shtetasit L. M nuk qëndrojnë dhe se janë të pa bazuara.

Në të njëjtin konkluzion kanë dalë edhe Ministria e Drejtësisë dhe DPB-ja të cilët nën përgjegjësinë e tyre institucionale dhe me tagrin që u njeh ligji nr.9397, datë 12.05.2005 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve”, shprehen se pas verifikimeve të kryera, asnjë nga pretendimet e ankuesit nuk qëndron.

Komisioneri konstaton se ky qëndrim bazohet në logjikën e gjithë dokumentacionit provues të depozituar në dosjen e ankuesit<sup>7</sup>.

Neni 7, pika 1, e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me veprim ose mosveprim nga ana e subjekteve ndaj të cilëve shtetasi L. M është ankuar, që të krijojë baza për mohimin e barazisë ose që ekspozon atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me të dënuarit e tjerë; apo në raport me të drejtat e tij ligjore.

Në përfundim, Komisioneri gjykon se ndaj shtetasit L. M nuk ka patur trajtim apo qëndrim diskriminues, nga ana e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën pranë Zyrës së KMD-së.

---

<sup>7</sup> Referuar kryesisht procesverbalëve respektivë, depozituar në dosjen e ankuesit.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjendjes shoqërore, të shtetasit L. M nga ana e Drejtorit të IEVP-së Fier, Shefit të Regjimit të Brendshëm, Shefit të Llogjistikës, Shefit të Kujdesit Social, Inspektorit të Grupit të Sigurisë dhe stafit të Shërbimit Policor, pranë IEVP Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**Robert GAJDA**

\_\_\_\_\_

**KOMISIONERI**

(shkaku: gjendja shoqërore)  
(fusha: të mira dhe shërbime)